



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KLOS
NJËSIA E PROKURIMIT

Klos, më 28/07/2026

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës – Shërbim Konsulence

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Për hartimin e kriterëve kualifikues Komisioni u bazua kryesisht në:

- Ligji 162/2020 “Për prokurimin publik”;
- VKM nr. 285/2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar;
- VKM nr. 354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.

Lloji i procedurës së prokurimit publik: “E hapur, e thjeshtuar” (Shërbime).

Objekti i procedurës: “Plane rlevime topografike dhe planimetri për pronat e bashkisë Klos”.

Burimi i financimit: Buxheti i Bashkisë Klos.

Afati i kryerjes së shërbimit: Afati i realizimit nga momenti i nënshkrimit të kontratës deri me datë 31.12.2026.

Këto kriterë janë vlerësuar të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese , natyrën dhe vlerën e procedurës. Përkatësisht, si vijon:

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 71355000-1, Shërbime topografike, **22114310-8**, Harta kadastrale, **30221000-4**, Hartat kadastrale dixhitale, **71356000-8**, Shërbime teknike.

VLERA E FONDIT LIMIT: 1,300,000 (*Një milion e treqind mijë*) lekë pa t.v.sh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Klos për nevojat institucionit, ka hartuar

procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, ku citojmë: “1. Bashke me dorezimin e kërkesave për pjesëmarrje ose te ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prove paraprake në vend të disa vertetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”, dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, ku citojmë: “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas pikes 1 të shtojcës 11 (Kriteret e Përgjithshme për Kualifikim).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024, 2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 520.000 lekë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bërë për të siguruar Autoritetin Kontraktor që Operatorët Ekonomik kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Kërkesa në fjalë është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si

dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Lloji i procedure është "Sherbim Konsulence", përcaktimi i vlerës së kërkuar është bere ne mbeshtetje te nenin 43, pika 2, germa "c" të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar ku percaktohet se: "40% të vlerës së parashikuar të kontratës ne procedurat e prokurimit..... dhe ne procedurat e prokurimit "Shërbim Konsulence" si dhe në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet forms elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë ne mbeshtetje te nenin 43, pika 1 " të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku percaktohet se: " Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”.

2.3 Kapaciteti teknik:

Operatori ekonomik duhet të paraqese dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontrates, në një vlerë jo më të vogël se 20 %, ose 260.000 lekë.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomike duhet të paraqesin dëshmitë e më poshtme:

- a) përpërvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të leshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotesuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) përpërvojën e mëparshme te realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturave tatimore të shitjes, të plotesuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara, dhe të deklaruar ne organet tatimore,

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në nenin 54 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme të shoqërisë në projektim ose licencë profesionale individuale (lëshuar nga Institucioni i Autorizuar sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e licensave profesionale në fushën e studimit e projektimit), e vlefshme ku të përfshihen kategoritë e mëposhtme:

Kategoria. 8 a → Rilevime inxhinierike

Kategoria. 8 b → Rilevime inxhinierike kadastrale

Kategoria. 8 c → Sisteme GIS

Kategoria. 8 d → Bazamente gjeodezike

Kategoria. 8 e → Projektim fotogrametrik dhe hartografik.

(Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i originës pranë institucionit përkatës, në plotësim të licensave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës).

Sqarim: Për licencat e lëshuara pas hyrjes në fuqi të Vendimit nr.943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave ‘Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë Liçensa profesionale të shoqërisë (e vlefshme) për projektim (lëshuar nga institucione të autorizuar sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e licensave profesionale në fushën e studim projektimit në ndërtim), e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mësipërme me ndryshimet përkatëse në emërtesë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, si dhe vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016” (shënim- përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse për realizimin e shërbimeve objekt kontrate).

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente. Licensat e mesiperme jane vendosur ne kuader te natyres se pergjithshme te komponentëve të projektimit që priten të realizohen në këtë procedurë.

Bazuar në objektivat e projektit dhe komponentët kryesorë të tij janë përcaktuar kategoritë e mësipërme të licensës së projektimit të Operatorit Ekonomik të cilat janë të domosdoshme për hartimin e projektit dhe përputhen me natyrën e shërbimit dhe kërkesat specifike të Termave të Referencës.

Paisje topografike, në pronësi ose me qira. Nëse është në pronësi të shoqërohet me faturën tatimore të blerjes.

- **1 (një) Total Station robotik**
- **1 (një) LiDAR / Laser Scanner**
- **1 (një) Dron gjeodezik me LiDAR dhe kamerë RGB minimumi 45 MP**
- **1 (një) licenca software CAD**
- **2 (dy) Automjete**

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Operatori ekonomik për realizimin e punimeve duhet të disponojë staf minimalisht **8 (tetë)** persona. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë disponimin e numrit të punonjesve, për periudhën **Janar 2026 – Qershor 2026**, në formularin përmbledhës të vetedeklarimit, sipas shtojcës 10. Ndërsa operatori ekonomik fitues, para lidhjes së kontratës, duhet të dorëzojë dokumentacionin si më poshtë:

a. Vertetim të leshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi ku të specifikohet numri i punonjesve për secilin muaj, për periudhën **Janar 2026 – Qershor 2026**.

b. Listepagesat e punonjesve sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi për periudhën **Janar 2026 – Qershor 2026**.

Ofertuesi duhet të ketë të punësuar një staf minimal prej 8 (tetë) personash nga të cilët:

- | | |
|-----------------------------------|---------|
| • Inxhinier gjeodet | 1 (një) |
| • Inxhinier gjeomatik/Markshajdër | 1 (një) |
| • Specialist IT | 1 (një) |
| • Ekspert GIS | 1 (një) |
| • Jurist | 1 (një) |
| • Shofer | 1 (një) |

Punonjës staf mbështetës

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Njesia e prokurimit për vendosjen e stafit i është referuar Termave të përgjithshme të referencës për objektet pjesë e kësaj procedure, pjesë e secilave do të jenë të licensuar për shërbimet që priten të realizohen.

Bazuar në objektivat e projektit dhe komponentët kryesorë të tij, janë përcaktuar kriteret e kualifikimit dhe kategoritë e mësipërme të licensës së projektimit për Personelin Kryesor të Operatorit Ekonomik, të cilat janë të domosdoshme për hartimin e projektit dhe përputhen me natyrën e shërbimit dhe kërkesat specifike të Termave të Referencës.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e

Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

2. Detyrat Kryesore

2.1 Përgatitja e planeve të rilevimit topografik me koordinata dhe ortofoto.

(Arsyetim: Për identifikim të saktë hapësinor dhe përputhje me sistemin kadastral shtetëror, sipas Ligjit nr. 111/2018.)

2.2 Përgatitja e hartës së vendndodhjes së pasurive.

(Arsyetim: Për inventarizim, monitorim dhe administrim të pasurive nga autoriteti kontraktor.)

2.3 Kryerja e matjeve teknike në terren për përcaktimin e kufijve të pasurive.

(Arsyetim: Për shmangien e konflikteve pronësore dhe garantimin e saktësisë ligjore, sipas Kodit Civil.)

2.4 Përgatitja e dokumentacionit tekniko-ligjor për ASHK.

(Arsyetim: Dokumentacioni është i domosdoshëm për regjistrim dhe përditësim të pasurive, sipas Ligjit nr. 111/2018.)

2.5 Operatori Ekonomik të shprehë dakortësinë ku është i gatshëm që të rreflektojë çdo ndryshim nga dokumentimi fillestarë deri në rregjistrimin e pronave në ASHK, gadishmëri në çdo kohë dhe pa asnjë kosto shtesë edhe pas përfundimit të kontratës.

KRITERE TË KUALIFIKIMIT

3. Kapaciteti Ligjor dhe Profesional

3.1 Licencimi Operatori ekonomik duhet të disponojë licencë projektimi për kategoritë 8a, 8b, 8c, 8d dhe 8e. (Arsyetim: Licencimi garanton të drejtën ligjore për ushtrimin e veprimtarisë, sipas Ligjit nr. 10081/2009.)

4. Kapaciteti Teknik – Stafi

4.1 Inxhinierë Gjeomatikë / Gjeodetë / Markshajder

Operatori ekonomik duhet të disponojë minimumi 2 inxhinierë, të regjistruar në kompani për të paktën 3 muajt e fundit, ku:

- 1 inxhinier me licencë individuale pika 8a 8b 8c 8d 8e dhe minimumi 10 vite përvojë

(Arsyetim: Përvoja e lartë kërkohet për pasuri me ndjeshmëri juridike dhe teknike.)

- 1 inxhinier me licencë individuale pika 8a dhe 8b dhe minimumi 5 vite përvojë

(Arsyetim: Siguron kapacitet për hartim dhe verifikim teknik.)

4.2 Ekspert GIS Operatori ekonomik duhet të disponojë minimumi 1 ekspert GIS, me minimumi 3 vite përvojë, i regjistruar për të paktën 3 muajt e fundit.

(Arsyetim: GIS është i domosdoshëm për menaxhimin e të dhënave hapësinore dhe integrimin me sistemet shtetërore, sipas Ligjit nr. 10325/2010.)

4.3 Juristë Operatori ekonomik duhet të disponojë minimumi 1 juristë, të cilët mund të jenë:

- të regjistruar në kompani për të paktën 3 muajt e fundit, OSE

(Arsyetim: Pasuritë lidhen me vendime gjyqësore dhe procedura ligjore, ndaj kërkohet mbështetje juridike e vazhdueshme, sipas Kodit Civil dhe Ligjit nr. 10192/2009.)

4.4 Specialist IT Operatori ekonomik duhet të disponojë minimumi 1 specialist IT, i regjistruar në kompani për të paktën 3 muajt e fundit.

(Arsyetim: Kërkohej për menaxhimin dhe funksionimin e infrastrukturës IT, përpunimin dhe arkivimin e të dhënave topografike dhe GIS, si dhe garantimin e sigurisë dhe integritetit të informacionit, sipas Ligjit nr. 9887/2008 dhe Ligjit nr. 10325/2010.)

4.5 Stafi Total Operatori ekonomik duhet të disponojë minimumi 10 persona staf.

(Arsyetim: Siguron kapacitet njerëzor të mjaftueshëm për realizimin paralel të shërbimeve.)

5. Kapaciteti Teknik – Pajisjet Operatori ekonomik duhet të disponojë (në pronësi ose me qira):

- 2 GPS gjeodezik

- 1 Total Station robotik

- 1 LiDAR / Laser Scanner

- 1 Drone gjeodezik me LiDAR dhe kamerë RGB minimumi 45 MP

- 1 licenca software CAD

- 2 automjete në pronësi

(Arsyetim: Pajisjet sigurojnë saktësi teknike dhe përmbushje të standardeve të matjeve topografike, sipas Ligjit nr. 111/2018.)

6. Standardet e Menaxhimit

Operatori ekonomik duhet të disponojë certifikata valide:

- ISO 9001:2015

- ISO 27001

- ISO 45001:2018

(Arsyetim: Garantojnë cilësinë e shërbimit, sigurinë e informacionit dhe shëndetin e sigurinë në punë, sipas Ligjit nr. 10237/2010 dhe Ligjit nr. 9887/2008.)

NJËSIA E PROKURIMIT

1. _____

2. _____

3. _____